



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Lënda: Procesverbal i mbledhje 16.09. 2022.

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak po ju vendosim në dispozicion për miratim procesverbalin e mbledhjes së datës 16.09. 2022.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot në **date 16.09. 2022** në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Gjirokastër. Mbledhja po zhvillohet online.

Marrin pjesë në mbledhje 18 anëtarë. Mungojnë në mbledhje; Kallajnxhi, Kore, Isaraj, Hilaj, Rami, Feruni, Hasko, Qeli, Nebiaj, Qafzezi, Xheko, Rova, Gjini.

Hapet mbledhja nga Z. Lavdi Hasani. Është korumi për fillimin e mbledhjes.

Z. Lavdi Hasani lexon kërkesën e Kryetarit të Bashkisë për mbledhjen jashtë radhe të Këshillit Bashkiak dhe rendin e ditës.

1. P/ Vendim “Për përdorimin e fondit të kushtëzuar me qëllim financimin e objektit “Mirëmbajtje e rrugës Zhulat”

Miratohet me 18 vota pro rendi i ditës.

Kërkohen sqarime nga ekzekutivi për këtë material.

Z. Asllan Karagjozi: Kërkojmë sqarim për projekt /aktin.

Sqarohet nga ekzekutivi arsyeja e këtij projekt akti nga znj. Artiste Koko.

Vendimi i mbledhjes së kaluar ka të bëjë me investim nga rruga kryesore , krijimin e një ure të re deri në gjatësi 700m, mirëmbajtja nga lapidary deri në gjatësinë 2.7km.

Z. Karagjozi: I saktë sqarimi i ekzekutivit.

Miratohet me 18 vota pro P/ Vendim “Për përdorimin e fondit të kushtëzuar me qëllim financimin e objektit “Mirëmbajtje e rrugës Zhulat”.

Mbyllet mbledhja nga z. Lavdi Hasani.

Sekretar

Etleva Yzo

Kryetar i Këshillit

Lavdi Hasani

